

V E N D I M
"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga,

GJYQTARE: ARDIANA BERA,

asistuar nga sekretare gjyqesore Aida Kaci, ne Tirane sot me date **12.06.2013**, me pjesemarrjen e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane perfaqesuar nga prokuror **z. Armand Gurakuqi**, mori ne shqyrtim kerkesen penale nr. 563 Akti me :

KERKUESE : **A.H**, e bija e (.....) dhe (.....), e datelindjes (.....), lindur ne (.....)e banuese ne (.....), me arsim te larte, e martuar, e padenuar, identifikuar me karten e identitetit (.....) **ne mungese**, perfaqesuar nga av. Ndue Gjoni anetar i Dhomes se Avokatise, Tirane me nr.1194 license, i autorizuar me prokure te posacme te dates 18.02.2013 e nr.315rep e nr.59kol

OBJEKTI : **1.**Kundershtim i vendimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane date 05.02.2013 per sekuestrimin prane bankes Intesa Sanpaolo te shumes 34.226.81 euro te depozituar ne emer te A.H.**2.** Kthimin e shumes 34.226.81 euro te depozituar ne emer teshtetases A.H prane bankes Intesa Sanpaolo sekuestruar me vendim te Prokurorise Rrethit Gjyqesor Tirane date 05.02.2013.

BAZA LIGJORE: Neni 212 e vijues te K.Pr.Penale

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, Gjykata pasi administroi provat shkresore; **degjoi perfaqesuesin e kerkuesit qe kerkoi:** - pranimin e kerkeses per kthimin e sendit te sekuestruar, shumes prej 34.226,81 (tridhjet e katermije e dyqind e njezet e gjashte, euro) ; **degjoi prokurorin** qe kerkoi mospranimin e kerkeses se kerkueses A.H; si dhe pasi e shqyrtoi ceshtjen ne teresi;

VEREN

Se, nga kerkuesia A.H eshte sjelle per gjykim kerkesa penale me objektin * Kundershtim i vendimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane date 05.02.2013, per sekuestrimin prane bankes Intesa Sanpaolo te shumes 34.226.81 euro te depozituar ne emer te A.H. Kthimin e shumes 34.226.81 euro te depozituar ne emer te shtetases A.H prane bankes Intesa Sanpaolo sekuestruar me vendim te Prokurorise Rrethit Gjyqesor Tirane date 05.02.2013.*

Gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi e provuar se: mbi bazen e materialit kallezues te derguar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit me date 05.02.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, ka rregjistruar procedimin penal Nr.825 per kryerjen e vepres penale te "Pastrimi i

produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale ”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Ne kuader te hetimit te ceshtjes penale, nga ana e prokurorit me date 05.02.2013, bazuar ne nenin 210 te K.pr. Penal eshte vendosur:* Kryerja prane bankes Intensa Sanpaolo, te sekuestrimit te shumes 34,226.81 euro depozituar ne emer te shtetases A.H dhe akteve te marreveshjes bankare perkatese. Nje kopje e vendimit ti komunikohet personit te interesuar...* Me date 05 shkurt 2013 me procesverbalin” Mbi ekzekutimin e vendimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane”, oficeri I policise gjyqesore Leonart Qorri ka bere ekzekutimin e vendimit te prokurorit date 05.02.2013, duke sekuestruar prane bankes IntesaSanpaolo shumen prej 34.226.81 euro , te depozituara ne emer te shtetases A.H.

Bazuar ne vendimin e prokurorit per kryerjen e sekuestrimit rezultoi se shtetesja A.H (kerkuese), eshte nena e shtetasit B.H, I cili eshte arrestuar ne portin e Marsejes –France per transportimin e 11(njembedhjete) kg lende narkotike kokaine. Shtetasja-kerkuese A.H ka gjendje te depozituar prane bankes Intesa Sanpaolo shumen prej 34.226,81 (tridhjet e katermije e dyqind e njezet e gjashte, euro). Ne vendimin per kryerjen e sekuestrimit nga ana e prokurorit theksohet se sasia e parave dhe aktet mbi te cilat eshte krijuar marredhenja bankare , vleresohet se perbejne prove materiale ne kuader te procedimit penal nr 825. Per kete arsye nevojitet te kryhet sekuestrimi i sasise se parave dhe akteve mbi te cilat eshte krijuar marredhenia bankare.

Me marrjen e njoftimit, per kete vendim ,brenda afatit te kerkuar ligjor, kerkuesja- ankuese A.H, ka paraqitur kerkesen prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per kthimin e sendit te sekuestruar, pasi nuk ka lidhje me procedimin penal nr 825. Perfagesuesi ligjor i kerkueses paraqiti ne cilesine e provës shkresore ekstraktin e regjistrimit tregetar date 03.06.2013, te leshuar nga qendra kombetare e regjistrimit, (QKR)-per te dhenat e subjektit “Person fizik” ku rezulton se subjekti “person fizik”, mban numrin e niptit, me emer subjekti B.H, data e rregjistrimit te tij eshte **23.03.2007**, vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne qytetin e Duresit me fushe veprimtarie “Agjensi turistike dhe biletari”, dhe statusi aktiv, I pa denuar penalisht, I pa denuar penalisht ne aktivitetin professional, dhe se nuk eshte ne proces likujdimi. Gjithashtu paraqiti edhe te dhena te leshuara nga banka IntesaSanPaolo ku pasqyrohen levizjet bankare te bera prane kesaj banke, hyrjet-daljet respektive qe nga data 01.04.2009, date kur eshte hapur kjo llogari, deri me date 01.04.2013, duke provuar pronësinë apo posedimin e ligjshëm të sendit të sekuestruar duke theksuar se kjo shume parash-euro e sekuestruar nga prokuroria nuk ka lidhje me procesin penal

qe eshte rregjistruar ne vitin 2013 prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kërkesë nuk u pranua nga prokurori i çështjes, i cili kerkoi mospranimin e kerkeses se kerkueses A.H.

Lidhur me sa me siper, Gjykata veren se, për zgjidhjen e kësaj mosëmarrëveshjeje duhet t'i referohemi nenit 217/1 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se : **Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se te merret vendimi perfundimtar. Kur eshte e nevojshme organi procedues urdheron te sillen sendet e kthyer.**

Ne rastin konkret, gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi e provuar se, kerkueses A.H, I eshte sekuestruar shuma prej 34.226,81 (tridhjet e katermije e dyqind e njezet e gjashte, euro) te depozituara ne emer te shtetases A.H, prane bankes *Intensa Sanpaolo bank*, sekuestruar me Vendimin- *Per Kryerjen e Sekuestrimit* te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane date 05.shkurt.2013,* gjate hetimit te procedimit penal Nr.825 viti 2013. Gjykata cmon se nuk eshte e nevojshme mbajtja e metejshme e ketij sendi te sekuestruar per qellime prove. Rezulton e provuar se llogaria bankare ne emer te kerkueses eshte aktive qe nga viti 2007 dhe nuk ka lidhje me ceshtjen penale te regjistruar ne vitin 2013.

Gjatë gjykimit perfaqesuesi ligjor i kerkueses arriti te provonte posedimin e ligjshme te tyre nepermjet provave te paraqitura.

Ne keto kushte, bazuar ne nenin 217/1 te K.Pr.Penale Gjykata çmon se, kerkesa e shtetases A.H per kthimin e sendeve personale të sekuestruara me proces-verbalin e dt.05.02.2013 është e bazuar në prova dhe ligj dhe për pasojë, duhet pranuar.

PER KETO ARSYE,

Gjykata, bazuar ne nenet 217-218 te K.Pr.Penale,

V E N D O S I

1. Pranimin e kerkeses se kerkueses A.H.
 2. Kthimin e shumes prej 34.226,81 (tridhjet e katermije e dyqind e njezet e gjashte, euro) te depozituara ne emer te shtetases A.H, prane bankes *Intensa Sanpaolo bank*, sekuestruar me Vendimin- *Per Kryerjen e Sekuestrimit* te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane date 05.shkurt.2013, gjate hetimit te procedimit penal Nr.825 viti 2013.
 3. Urdhërohet policia gjyqësore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi nëse shuma e mësipërme nuk mbahet e sekuestruar për llogari të ndonjë procedimi penal tjetër.
 4. Kunder këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së tij.
- **U shpall në Tiranë, sot më date 12.06.2013.**

**SEKRETARE
AIDA KACI**

**GJYQTARE
ARDIANA BERA**